

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 116/11 Prot.

Vlorë, më 20.09.2019

VENDIM

Nr. 50, datë 20.09.2019

PËR

**MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA RIALOKIMEVE/NDRYSHIMEVE NË PLANIN
BUXHETOR TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË PËR VITIN 2019**

Mbështetur në shkronjën h, pika 1 në nenin 38 në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.09.2019

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht rialokimet dhe ndryshimet e mëposhtme në planin buxhetor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2019:


a. Shtesa:

a.1. Zëri: *Investime Artikulli 231 (09450)* program i aktivitetit të përditshëm

a.1.1. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Rehabilitimi i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike" në vlerën 53,924 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 493/19 prot., datë 28.05.2019 të Sektorit të Shërbimeve me objekt "Relacion mbi Bodrumin e Godinës C", shkresën nr. 128/3 prot., datë 11.07.2019 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike me objekt "Kërkesë", si dhe Detyrën e Projektimit "Rehabilitimi i katit nëntokë të Fakultetit të Shkencave Teknike".

a.1.2. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Krijimi i Bibliotekës Digjitale të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" në vlerën 30,000 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1153 prot., datë 18.09.2019 të Sektorit të IT-së me objekt "Propozim për vazhdimësin e Bibliotekës Digjitale të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë".

a.1.3. Rialokim të fondeve për investime në zërin " Blerje fond biblioteke" në vlerën 1,827 lekë (000) mbështetur në kërkesat e paplotësuara të fakulteteve për fond biblioteke.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

a.2. Zëri: *Investime Artikulli 231 (09470)* program i projekteve dhe kërkimit shkencor

a.2.1. Rialokim i fondeve për investime në zërin "Blerje mjete pune" në vlerën 1, 302 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1145 prot., datë 17.09.2019 të Koordinatorit të Projektit AFRIMED me objekt "Kërkesë për mbështetje financiare".

a.3. Zëri: *Kërkim shkencor Artikulli 602 (09470)* program i projekteve dhe kërkimit shkencor

a.3.1. Rialokim të fondeve për investime në zërin "Shpenzime per aktivitete promovuese " në vlerën 1, 302 lekë (000) mbështetur në shkresën nr. 1147 prot., datë 17.09.2019 të Koordinatorit të Projektit 'Business Club' me objekt "Kërkesë për rialokim të fondeve për mbështetje të aktiviteteve të UV në Projektin 'Business Club'" për mbështetje financiare dhe vënie në dispozicion të një fondi mbështetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave.

b. Pakësime:

b.1. Zëri: *Investime Artikulli 231 (09450)* program i aktivitetit të përditshëm

b.1.1. Rialokimin e fondeve për investim për ngritjen e godinës së re të Fakultetit të Shëndetit në vlerën 84,700 lekë (000) në zërat e investimeve të sipërpërmendura pasi për vitin buxhetor 2019 nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk është konfirmuar "Letër premtimi" për mbështetje financiare për investimin kryesor të planifikuar në buxhetin e vitit 2019 "Ngritjen e Godinës së Re të Fakultetit të Shëndetit Publik".

b.2. Zëri: *Investime Artikulli 230 (09450)* program i aktivitetit të përditshëm

b.2.1. Rialokimin e fondit të vënë në dispozicion për këtë zë në vlerën 3,799 lekë(000) në zërat e investimeve të sipërpërmendura si rezultat i mosrealizimit të investimit të ngritjes së godinës së re të Fakultetit të Shëndetit Publik për vitin buxhetor 2019.

2. T'i përcjellë për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit rialokimet/ndryshimet në planin buxhetor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2019.

2. Vendimi protokollat dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

